



**Z. Endrit Kapaj**  
Drejtor Ekzekutiv



## **PROCEDURA E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE TË HUAJA TË ARBITRAZHIT NË SHQIPËRI**

Kapitulli IX, Titulli III i Pjesës së Dytë të Kodit të Procedurës Civile Shqiptare, nenet 393 deri 399, përmbajnë dispozitat në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja. Këto janë gjithashtu të zbatueshme për vendimet e arbitrazhit ndërkombëtar.

Sipas nenit 394 të Kodit të Procedurës Civile Shqiptare, vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur:

- i. sipas ligjit shqiptar, gjykata e huaj nuk ishte kompetente për çështjen; ose*
- ii. kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i janë njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësi që të mbrohet; ose*
- iii. midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare; ose*
- iv. është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë; ose*
- v. i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij; ose*
- vi. nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar. ( Politikat publike)*

Sipas nenit 399 të Kodit të Procedurës Civile Shqiptare, dispozitat e nenit 394 të Kodit të Procedurës Civile Shqiptare do të zbatohen

*mutatis mutandis* për vendimet e arbitrazhit ndërkombëtar.

Kodi i Procedurës Civile Shqiptare më tej parashikon që nëse ekzistojnë marrëveshje specifike midis Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të huaja, atëherë kushtet e marrëveshjes ndërkombëtare do të zbatohen në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e gjykimeve të këtij vendi.

Në fakt, sipas nenit 122 të Kushtetutës së Shqipërisë, çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj bëhet pjesë e legjislacionit vendas pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Neni 122 i Kushtetutës Shqiptare parashikon më tej që, në rast konfliktesh midis dispozitave të ligjeve të brendshme dhe atyre të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, dispozitat e këtyre të fundit do të prevalojnë.

Ndërsa Republika e Shqipërisë ratifikoi Konventën e Nju Jorkut (1958) për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit, dispozitat vetë-ekzekutuese të Konventës së Nju Jorkut janë pjesë e legjislacionit të brendshëm në Shqipëri. Për më tepër, në përputhje me Kushtetutën Shqiptare dhe Kodin e Procedurës Civile Shqiptare, dispozitat e Konventës së Nju Jorkut do të prevalojnë në rast konflikti. Sipas Konventës së Nju Jorkut, Shqipëria ka marrë përsipër të përmbushë detyrimet e mëposhtme:



- të njohë dhe zbatojë vendimet e huaja të arbitrazhit dhe të njohë marrëveshjet për të paraqitur mosmarrëveshjet në arbitrazhin ndërkombëtar.

Sic u përmend më lart, neni 399 i Kodit të Procedurës Civile Shqiptare parashikon që procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja do të zbatohet gjithashtu për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar. Vendimet e huaja të arbitrazhit mund të zbatohen në Shqipëri, me kusht që ato të "njihen" në Shqipëri në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile Shqiptare. Sipas Kodit të Procedurës Civile Shqiptare, njohja e një vendimi të huaj arbitrazhi jepet nga gjykata kompetente e apelit me kërkesë të palës së interesuar. Pasi të njihen, vendimet e huaja të arbitrazhit kanë të njëjtat efekte si gjykimet e brendshme.

Procedura për njohjen e një vendimi arbitrazhi ndërkombëtar fillon duke paraqitur një padi para gjykatës kompetente të apelit. Edhe pse, zyrtarisht, procedurat e tilla konsiderohen të një natyre deklarative (proces hiri ("Gracious process")), gjykata e apelit do të kërkojë që pala tjetër (pala e dëmtuar) të thirret sipas ligjit për të marrë pjesë në seanca gjyqësore.

Sipas nenit 396 të Kodit të Procedurës Civile Shqiptare, kërkesa për njohjen e një vendimi arbitrazhi ndërkombëtar të paraqitur në gjykatën kompetente të apelit duhet të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

- I. kopja e vendimit që duhet të zbatohet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe i legalizuar nga noteri;
- II. kopja e vendimit/vërtetimi i lëshuar nga institucioni i arbitrazhit që ka lëshuar

*vendimin që vendimi ka marrë formë të prerë;*

- III. *prokura, nëse kërkesa paraqitet nga një përfaqësues i palës së interesuar.*

Kodi i Procedurës Civile Shqiptare nuk kërkon paraqitjen e marrëveshjes së arbitrazhit si kusht për njohjen e vendimit të huaj në Shqipëri. Dispozita të tilla janë larg parashikimit të nenit 4 të Konventës së Nju Jork-ut i cili kërkon që kërkesa për ekzekutimin e një vendimi të shoqërohet nga marrëveshja e arbitrazhit.

*Mohim: Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë artikull janë vetëm deklarata personale të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pozicionin e ICC Albania. Përmbajtja e artikullit është vepra origjinale e autorit. Autori merr përgjegjësinë për çdo shkelje të autorësisë. Versioni origjinal i artikullit është në gjuhën angleze*